

Dr. Camilo Cruz
Na ishte një herë një lopë

Braktiseni pretekstin, mos u kënaqni me atë që keni dhe shkoni drejt suksesit



botimet/publishing
ELTA BS

përmbajtja:

- 13 **Parathënia**
- 17 **Hyrja**
- Kaptina e parë
- 27 **Rrëfimi për lopën**
- Kaptina e dytë
- 41 **Mos prisni çdo lopë të pëllasë**
- Kaptina e tretë
- 53 **Para çdo lope njëherë është rriçi**
- Kaptina e katërt
- 73 **Lopët lara-lara**
- Kaptina e pestë
- 91 **Gjeneza – nga ku rrjedhin lopët**
- Kaptina e gjashtë
- 103 **Lopët nuk merren si dhuratë**
- Kaptina e shtatë
- 113 **Si ta heqësh qafe cilëndo lopë qoftë**
- Kaptina e tetë
- 127 **Ka vetëm një mënyrë si ta zblukni lopën**
- Kaptina e nëntë
- 145 **Krijimi i zonës së pastër pa petekste**

Me porosinë e librave të vet dr. Kruz, pa dyshim, do të ushtrojë ndikim të fuqishëm në botë. Ai është një nga autoritetet e prezantimit në opinion. Kamiloja në librat e vet paraqet urtinë, urtinë brilante, dhe një det njohurish me të cilët nxit njerëzit për të bërë ndryshime të shpejta dhe të dobishme.

*Mark Viktor Hansen,
bashkautor i librit Ilaç për shpirt.*

Puna e dr. Kamilo Kruzit, pa dyshim, do të ketë ndikim të pakufishëm në brezat që tash do të vijnë. Entuziazmi me të cilin frymëzohen prezantimet e tij është element kyç që nxit njerëzit që të hulumtojnë dhe të zbulojnë rrugën e vërtetë drejt suksesit jetësor. Zotësia e tij që të frymëzojë dhe të motivojë të tjerët në rrugën drejt realizimit të qëllimeve do të ketë ndikim pozitiv në strukturat elite në shoqërinë tonë.

*Eduards James Olmos, artist dhe bashkëthemelues
i Festivalit latin të librit dhe të familjes*

Amerika ende nuk e ka krijuar ciceronin e vet jetësor, prandaj e ka shkruar Kamiloja.

J. U. Keep Walking Fund, Men's Journal Magazine

Dr. Kruzi është autoritet, i qartë, i mprehtë në gjuhë dhe me qëndrime pozitive ndryshon botën. Supozoj se dr. Kruzi si mendimtar, orator dhe krijues gjithë rajonin e Amerikës Latine do ta çojë në një rrafsh më të lartë.

Brian Tracy, shkrimtar dhe orator.

Dr. Kamilo Kruz është Tony Robbinsi latinoamerikan, dr. Phili hispanoamerikan.

Sun Sentinel, South Florida Newspaper.

Ju falënderoj pse na e keni falur dijen dhe pasionin tuaj me prindërit në qendrën tonë. Porositë tuaja inkurajuese dhe motivet për suksesin përputhen përsosmërisht në misionin tonë. Jo vetëm pse na keni ofruar vizionin, por edhe pse keni prezantuar hapa konkretë dhe qëllime konkretë për ta arritur suksesin. Libri *Na ishte njëherë një lopë* do të jetë për prindërit tanë një mjet i mrekullueshëm, të cilin do ta shfrytëzojnë kur do të kërkojnë (gjatë kohës sa do të kërkojnë) zbatimin e fjalëve tuaja në jetën e vet.

Dr. Heather M. Huntley, KidWorks

Librat edhe prezantimet e dr. Kamilo Kruzos kanë ndryshuar jetën e shumë njerëzve. Ai na jep fuqi dhe na mëson si mund ta përparojmë kualitetin e jetës.

La Opinion, Los Angeles Newspaper

Kudo i gjej librat e dr. Kruzos. E ftoj të bashkohet me programin tim, sepse konsideroj se idetë e tij mbi suksesin mund të zbatohen kudo e jo vetëm në SHBA.

Dom Francisko, Univision

Libri juaj ka ushtruar ndikim të fuqishëm në jetën time dhe më ka cytur të krijoj firmën time, e cila sot vepron në disa shtete.

Ju falënderoj pse shfrytëzoni kohën tuaj për të shkruar libra të cilët frymëzojnë në mënyrë të sinqertë mijëra njerëz që të realizojnë potencialin e vet.

Wenceslao Cesarec, Themelues i Faqes së Internetit Patagon.com

Ju falënderoj pse mbajtet prezantimin në bibliotekën tonë. Publiku është zbavitur dhe, pa dyshim, shumica kanë lëshuar promocionin duke menduar dhe duke shestuar plane se në ç'mënyrë t'i bëjnë realitet ëndrrat e veta. Teknikat tuaja do t'iu ndihmojnë t'i mposhtin të gjitha pengesat e pakalueshme në të cilat do të ndeshin, dhe do t'ia afrojnë t'ia zbatojnë qëllimet e tyre.

Debbie Llenza, Broward County Library

Porositë e mrekullueshme dhe komunikimet e shkëlqyeshme me të gjithë publikun (autoritetet ushtarake me pozita të larta, drejtorët gjeneralë, mysafirët). Të gjithëve iu ka pëlqyer porosia që na e keni dërguar.

U.S. Air Force / Aerospace Corporation

Në emër të drejtoratit dëshiroj t'ju falënderoj personalisht! Prezantimi juaj ishte tejet i urtë dhe me autoritet! Keni krijuar një kontakt të shkëlqyeshëm me publikun, i cili me një interesim të madh ka përcjellë prezantimin tuaj dhe kam absorbuar çdo fjalë tuajën dhe porosinë mbi suksesin tuaj personal dhe mbi udhëheqjen tuaj. Jeni njëri nga oratorët më të mirë motivues, të cilin e kemi dëgjuar ndonjëherë!

Xhenet Kronik, Unioni i Grave Afariste Latine.

Dëshiroj të shpreh falënderimin tim të thellë, sepse, edhe unë, sikundër ju, besoj se rininë tonë do të duhej ta inkurajonim në atë mënyrë që ta mësojmë me qëndrimet pozitive me ndihmën e të cilave do të marrin kontrollin mbi ardhmërinë e vet dhe do

ta përvetësojnë përgjegjësinë e qindpërqindtë për suksesin e vet. Konsideroj se çdo student do të duhej të kishte informacion mbi konceptin tuaj ndaj të cilit të gjithë jemi arkitektë të fatit personal.

Bert Foti, Rotary Club

Me librin *Na ishte njëherë një lopë*, dr. Kruz na mëson sesi të depërtojme nëpër pyllin e kufizimeve dhe të barrierave të bëra dhe, në fund, çfarë vendimesh të marrim mbi jetën dhe fatin tonë dhe të fusim ndryshime pozitive në jetën tonë. Jua rekomandoj në mënyrë të sinqertë që porositë e tij të fuqishme dhe inkurajuese t'i shfrytëzoni si armë me ndihmën e së cilës do ta avanconi jetën tuaj.

Dino Nasi, Federal Express

Për më shumë se njëzet vjet pune në librari dhe në programim, ende asnjëherë nuk kam marrë pjesë në ndonjë seminar ku publiku ka qenë aq shumë i interesuar dhe i kënaqur. Mund të them vetëm kaq se dr. Kruz është orator me motivim të jashtëzakonshëm dhe të gjithë pjesëmarrësit e seminarit kërkonin që seminari të organizohet edhe një herë.

Diana Morales, Houston Public Library

Prezantimi suprem i dr. Kruzit, pa dyshim, ka ndihmuar të fokusojmë mendimet dhe t'i përqendrojmë në qëllimet personale dhe korporuese. Ishte kjo një mënyrë e mrekullueshme si t'ia fillonim vitit dhe jam i sigurt se do t'i realizojmë qëllimet.

Ciba Geigy, menaxher kryesor për Amerikën Latine.

Prezantimi i librit tuaj *Na ishte njëherë një lopë* ka hasur në mirëkuptim ndër shumë të punësuar tanët të profileve të ndryshme. Edhe tash dëgjojmë vetëm komentime të mrekullueshme në dobi të prezantimit tuaj dhe të porosive

Mendime për librin

të drejtuara. Menaxherët tanë që tani do të shfrytëzojnë disa nga idetë tuaja mbi suksesin në mbledhjet interne të resoreve personale. Ju falënderojmë nga zemra pse ndatë me ne talentin tuaj dhe kohën tuaj.

Carla Fountain, Orange County Library.

Parathënia

Ka tash tridhjetë vjet që shkruaj mbi suksesin. Po ç'është sukcesi? Ç'është ajo që na bën të kemi sukses? Pse na bëhet sikur disa e arrijnë këtë gjë me pak mund, kurse të tjerët bien copë vite me radhë e s'mund ta arrijnë dot?

Nga bisedat me mijëra njerëz nga e gjithë bota, kam krijuar bindjen se të gjithë njerëzit që kanë sukses nga cilado anë e botës qofshin, kanë të paktën një karakteristikë të përbashkët: ata kurrë s'i trillojnë gjërat për të rrëfyer pse ndodh kjo ashtu, madje as qahen sesi do të duhej t'iu ndodhte. Njerëzit të cilëve iu ecin punët, marrin përgjegjësinë dhe punojnë mbi realizimin e planeve. Kuptohet, kjo nuk do të thotë se përherë kanë sukses menjëherë, porse ngadhënjimtarët nuk dorëzohen kurrë. Edhe nëse gjunjëzohen, menjëherë çohen dhe vazhdojnë më tutje lojën.

Kam kuptuar se, edhe pse pjesa jonë dërrmuese pretendon të shënojë arritjet e mëdha, shpesh pajtohem me vendin e dytë. Kemi dëshirë ta bëjmë jetën me plot afsh, porse aq shumë nga ne ia dalim në skaj duke arnuar jetën. Ka shumë që fshihen në zonën e vet të sigurt, mësohen me jetën e saj, dhe e kuptojnë shpejt se e gjitha ajo e mirë që ua ka ofruar jeta, thjesht iu ka ikur nga duart. Një nga leksionet që e kam mësuar është ajo se hapi i parë që për realizimin e rezultateve të mrekullueshme në jetë është të mos ua vësh veshin gjithë atyre thashethemeve që na pengojnë ta realizojmë maksimumin tonë.

Shumë nga librat më të mirë nga fusha e zhvillimit personal dhe profesional shfrytëzojnë metaforat apo rrëfimet e shkurtra që të ilustrojnë rëndësinë e qëndrimeve dhe të ideve të caktuara që luajnë rol kyç për të arritur sukses.

Libri *Na ishte njëherë një lopë* tregon intuitivisht dhe me besim se çka mund të ndodhë nëse jetën tonë e mbisundojnë pretekstet. Kjo gjë, pa mëdyshje, është një nga metaforat më të mira që kam takuar rreth asaj sesi ta zhdukim mediokritetin nga jeta jonë.

Lopa simbolizon çdo pretekst, ose arsyetim që na kufizon të bëjmë jetën tonë të lumtur. Ky tregim i rrëfyer në mënyrë të mrekullueshme domosdo do të pushtojë edhe zemrën tuaj dhe do t'ju ngashënjë ta pranoni grishjen për t'u çliruar nga çdo shfajësim ose, t'i përdor fjalët e Kamilos, që "ta vrisni lopën tuaj".

Është e vërtetë se të gjithë ne, në kurrizin tonë, bartim shumë më tepër "lopë" sesa kemi gatishmëri ta pranojmë. Të shumtët nga ne kemi prirjen të gjejmë arsye të ndryshme, duke shpresuar se jeta nuk është edhe aq e keqe sa duket. Të gjithë kemi paletën e larme të përgjigjeve dhe të shpjegimeve, për vonesën dhe për kryerjen shkel-e-shko të detyrave.

Ky libër është një pasqyrë e qartë për efektet pozitive të vendimit definitiv që të flakim çdo pretekst që dezorienton jetën tonë. Ajo na ofron projektin si të jetojmë, ku ka mundësi që, hap pas hapi, t'i realizojmë që të gjitha ëndrrat tona.

Kamilo thaujse ka marrë obligimin që me ndihmën e librave të vet të fusë ndryshime të fuqishme në botën në të cilën jetojmë. Ai bart mençurinë, meditimet dhe njohuritë brilante, të cilat për një çast bëhen të dobishme për lexuesit dhe i bëjnë të fortë sa të zbatojnë në praktikën jetësore strategjitë specifike në mënyrë që ta ndryshojë përgjithmonë jetën e vet.

Kam shpresë se do ta kuptoni provokimin e tij dhe do ta flakni mundësinë që të pajtoheni me një jetë më pak të

dinjitetshme sesa ajo që e meritoni. Besoj se do të përjetoni kënaqësinë duke lexuar këtë libër ashtu siç kam përjetuar kënaqësinë edhe unë dhe besoj se do të keni mundësinë që të bëni jetën pa mediokritet, të hapur me arritje të mëdha të rezervuara për ata që marrin guximin të ëndërrojnë ëndrra të mëdha.

Mark Viktor Hansen